

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ 208/24 dhe 16/25), duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga A1 Serbia doo Beograd, me selie të regjistruar në rr. Milutin Milanković 1zh, 11070 Novi Beograd, Serbi, të dorëzuar përmes Martin Ivanov, avokat nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 06.05.2026, mori këtë:

AKTVENDIM

1. Konstatohet se përqendrimi me të cilin A1 Serbia doo Beograd, me selie të regjistruar në rr. Milutin Milanković 1zh, 11070 Novi Beograd, Serbi, synon të fitojë kontrollin e vetëm mbi DEKS doo Beograd, me seli në adresën Zmajeva 12v, 11080 Zemun, Beograd, Serbi, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve, dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2. Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë dhe për aktvendimin në shumë prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21), në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, kodi dhe programi i të ardhurave 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 06.04.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), u dorëzua njoftimi për përqendrim nga ana e A1 Serbia doo Beograd, me seli të regjistruar në rr. Milutin Milanković 1zh, 11070 Novi Beograd, Serbi, me të cilin A1 Serbia doo Beograd synon të fitojë kontrollin e vetëm mbi DEKS doo Beograd, me seli në adresën Zmajeva 12v, 11080 Zemun, Beograd, Serbi, përmes shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit që nga dita e pranimin të tij dhe, në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtesave të tij, konstatoi si vijon:

Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:

A1 Serbia d.o.o. Beograd është pjesë e Grupit A1 Telekom Austria (*A1 Telekom Austria Group*) dhe është indirekt në pronësi të Telekom Austria AG (Telekom Austria AG), shoqëri aksionare e themeluar dhe që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Austrisë, me seli të regjistruar në adresën Lassallestrasse 9, 1020 Vjenë, Austri (*Lassallestrasse 9, 1020 Vienna*,

Austria). Telekom Austria AG është një kompani holding, e cila nuk ofron asnjë shërbim. Portofoli i biznesit të Grupit A1 Telekom Austria përbëhet nga aktivitete në fushën e telefonisë zanore, qasjes në internet me bandë të gjerë, shërbimeve multimedia, të dhënave dhe zgjidhjeve TI.

Grupi A1 Telekom Austria është i pranishëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes:

-A1 MAQEDONIA SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Sheshi "Presveta Bogorodica" nr. 1, Shkup – Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, e cila është aktive në veprimtaritë e telekomunikacionit kabllor, pa tel dhe satelitor;

-TELEMEDIA SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Sheshi "Presveta Bogorodica" nr. 1, Shkup – Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, e cila është aktive në veprimtaritë e shpërndarjes së filmave, video-programeve dhe programeve televizive; dhe

-LINWORKS SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Sheshi "Presveta Bogorodica" nr. 1, Shkup – Qendër, Republika e Maqedonisë së Veriut, e cila është aktive në fushën e programimit kompjuterik.

Grupi A1 Telekom Austria ka gjeneruar indirekt qarkullim në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

-DEKS d.o.o. Beograd ka si veprimtari kryesore programimin kompjuterik. DEKS ofron shërbime të personalizuara dhe fokusohet në zhvillimin e zgjidhjeve softuerike inovative dhe automatizimin e proceseve të biznesit. Në tri dekadat e fundit, DEKS ka zhvilluar sisteme informative për kompani, banka dhe institucione të shumta në Evropën Qendrore dhe Lindore. Këto aktivitete janë të kufizuara në territorin e Serbisë dhe të vendeve të Ballkanit;

-DEKS d.o.o. Beograd nuk ka asnjë aktivitet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nuk ka realizuar qarkullim në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bën pjesë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) pika 2) dhe neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i paraqitur bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, pasi i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pikat 1) dhe 2) të Ligjit

Komisioni, duke pasur parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikën 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se ato janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, edhe bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin apo shtrembërimin e ndjeshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik:

Kundër këtij aktvendimi mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
KRYETARE**

Mr. Малинка Силјановска Николиќ